



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE SHËRBIME
KORÇË

Nr 202 prot

Korçë më 15.06 .2026

Lënda: Njoftim për vend të lirë

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive
Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore
Drejtorisë së Marëdhënieve me publikun

Tiranë

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 "Për nxitjen e Punësimit", Ligjit nr.15/2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të Udhëzimit nr. 759 , datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përbërjen e Njësise së Zhvillimit të Institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,

Ofruesi Publik i AFP-së , Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë

Ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

(Një) Punëtor (Bujqësi – Blektori) , Punonjës i Bazës Prodhuese në Korçë.

1.Kriteret e përgjithëshme dhe kriteret e posaçme për personelin mbështetës në Shkollën Profesionale Shërbime Korçë, janë:

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon :

- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimi

Aplikanti duhet të plotësoje Kriteria të posaçme si vijon:

- a) Të ketë nivel arsimor të mesëm ose shkollë të mesme profesionale në fushën në shpalljen për pozicionin përkatës.
- b) Të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit , e cila përmban dokumentacionin e kërkuar , sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë :

- a) Letër motivimi për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në), sipas shtojces 11 të këtij udhëzimi
- c) Kartën e identitetit,
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- ë) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në cv;
- f) Çertifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- g) Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- gj) Vërtetim të gjëndjes gjyqësore;
- h) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi .
- i) Të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre.

Dokumentat në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentat e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda datës...25.06.2026

3. Vlerësimi I kandidatëve do të bëhet referuar përcaktimeve të udhëzimit nr 759 ,datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë menaxhimin e Burimeve Njerëzore,Përbërjen e Njësise së Zhvillimit të Institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit" i ndryshuar,

TATIANA MERO
DREJTOR I SHKOLLËS

